


Statistikat e Pagave

Tremujori II - 2019

Tiranë, 11 Shtator 2019: Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të dytë 2019, është 52.645 lekë, duke u rritur me 4,5 % krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar.


Fig. 1 Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri (lekë)



Gjatë tremujorit të dytë 2019, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit është 2,15 herë më e lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar, ndërsa në grup-profesione e Tregtisë; Transportit; Aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor është 26,1 % më e ulët.

Gjatë tremujorit të dytë 2019, paga mesatare bruto për grup-aktivitetin Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi, ka rritjen më të madhe prej 13,2 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, ndërsa Ndërtimi ka një ulje prej 2,6 %.


Fig. 2 Paga mesatare mujore bruto sipas aktiviteve ekonomike (lekë)



Gjatë tremujorit të dytë 2019, paga mesatare mujore bruto, për një të punësuar në grup-profesionin e ligjvënësve, nëpunësve të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorëve ekzekutivë është 90,0 % më e lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar, ndërsa në grupin e Punëtorëve (Profesione elementare) është 39,3 % më e ulët.

Paga për grup-profesionin e Nëpunësve ka rritjen më të madhe prej 7,7 % gjatë tremujorit të dytë 2019, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, ndërsa për grup-profesionin e të punësuarve si Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë ka rritjen më të vogël, prej 0,01 %.

Fig. 3 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve (lekë)



Tab. 1 Paga mesatare mujore bruto dhe paga minimale e miratuar (lekë)

Përshkrimi	II/16	III/16	IV/16	I/17	II/17	III/17	IV/17	I/18	II/18	III/18	IV/18	I/19	II/19
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë	47.038	46.933	49.409	47.143	49.150	48.863	50.614	49.145	50.392	50.015	52.312	51.531	52.645
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin shtetëror	54.500	54.550	54.600	56.500	60.500	60.650	61.600	59.728	60.595	60.494	63.276	61.384	63.207
Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë në sektorin privat	43.161	42.851	45.792	42.853	43.997	43.630	45.631	44.796	45.667	45.274	47.299	46.982	47.894
Paga minimale e miratuar	22.000	22.000	22.000	22.000	24.000	24.000	24.000	24.000	24.000	24.000	24.000	26.000	26.000

Burimi i informacionit: Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Tab. 2 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-aktiviteve ekonomike (lekë)

NVE Rev2 (seksion)	Aktiviteti ekonomik sipas NVE Rev2	II/16	III/16	IV/16	I/17	II/17	III/17	IV/17	I/18	II/18	III/18	IV/18	I/19	II/19
	Gjithsej	47.038	46.933	49.409	47.143	49.150	48.866	50.614	49.145	50.392	50.015	52.312	51.532	52.645
A	Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	33.944	34.292	35.065	34.621	36.657	36.486	37.187	36.822	36.961	36.334	37.343	37.956	39.313
B,C,D,E	Industria gjithsej	39.158	40.193	42.451	39.247	39.688	39.911	42.615	41.023	41.464	41.711	44.672	43.463	43.607
F	Ndërtimi	40.827	41.042	44.225	42.394	42.612	43.354	44.015	43.630	43.654	43.749	43.475	42.428	42.521
G,H,I	Tregtia; transporti; aktivitetet e akomodimit dhe shërbimit ushqimor	33.622	33.545	35.483	33.553	34.560	34.786	35.501	35.375	36.561	36.555	38.292	38.558	38.892
J	Informacioni dhe komunikacioni	78.884	71.051	79.757	69.591	77.004	72.284	74.782	71.497	78.423	75.597	77.719	76.037	87.605
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	107.133	95.314	106.047	95.403	111.199	96.521	111.368	100.455	114.162	100.609	111.626	101.734	113.339
L,M,N	Aktivite të pasurive të paluajtshme; Aktivite shkencore, profesionale dhe teknike; aktivite të shërbimeve administrative dhe mbështetëse	51.943	53.151	56.547	54.494	54.729	56.086	58.355	57.819	58.247	59.157	60.807	59.726	60.102
O,P, Q	Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm; arsimi; shëndetësia dhe aktivite të punës sociale	55.746	56.278	57.073	56.666	60.403	60.826	61.755	60.306	60.756	61.103	62.070	61.554	63.276
R,S,T,U	Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivite të tjera shërbimi	45.430	45.673	49.005	47.515	49.528	49.186	51.301	49.349	49.740	49.168	56.560	57.402	56.295

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Tab. 3 Paga mesatare mujore bruto sipas grup-profesioneve ekonomike (lekë)

Grup-profesionet sipas ISCO-08	II/16	III/16	IV/16	I/17	II/17	III/17	IV/17	I/18	II/18	III/18	IV/18	I/19	II/19
Gjithsej	47.038	46.933	49.409	47.143	49.150	48.863	50.614	49.145	50.392	50.015	52.312	51.532	52.645
Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë	96.513	95.383	97.838	91.777	97.165	93.109	99.371	96.166	100.035	97.297	101.886	96.656	100.049
Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	63.906	63.841	66.616	63.616	66.561	66.469	68.471	66.097	67.491	68.024	70.032	68.667	70.706
Teknikë dhe specialistë në zbatim	51.344	51.499	54.246	52.453	54.028	53.824	55.954	54.650	55.562	56.168	59.932	58.923	59.773
Nëpunësit	46.872	47.335	51.078	49.051	50.219	51.133	53.041	51.082	51.758	52.981	56.312	55.213	55.756
Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve	34.473	34.533	36.011	35.209	37.021	37.123	37.924	37.770	38.077	37.040	38.235	39.081	39.736
Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit	27.728	28.285	28.104	28.104	29.918	30.643	30.816	30.861	30.932	31.151	31.164	32.370	32.462
Zejtarrë, artizanë dhe profesione të lidhura me to	30.531	30.987	33.913	32.176	33.085	33.711	35.340	33.898	34.516	34.782	36.438	35.578	35.958
Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve	31.445	31.668	33.759	32.467	33.812	34.379	35.716	34.653	35.141	35.439	36.637	35.781	36.232
Punëtorë (Profesione elementare)	26.944	27.090	28.166	27.467	28.942	29.311	30.101	29.910	30.344	30.407	31.334	31.409	31.941
Forcat e armatosura	53.563	53.797	55.463	55.029	58.457	58.318	60.466	59.613	59.645	59.087	59.150	59.379	63.522

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i të dhënave për pagat përmbajnë të dhëna të detajuara për nivelin e pagave, shpërndarjes dhe ndryshimin e tyre përgjatë tremujorëve. Këto statistika ofrojnë një mundësi për të krahasuar pagat në aktivitete ekonomike të ndryshme dhe në grup-profesione të ndryshme. Statistikat mbi pagat janë gjithashtu të një rëndësie të veçantë për monitorimin e treguesve ekonomikë që përdoren nga politikë-bërësit, punëdhënësit dhe sindikatat për të vlerësuar kushtet e kërkesës dhe të ofertës për punë.

Baza ligjore

- Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare;
- Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021.
- Memorandumi i Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Burimi i informacionit

Burimi i të dhënave mbi pagat është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bazë të memorandumit të bashkëpunimit i dërgon INTAT-it, të dhënat nga Listëpagësa (E-SIG 025).

Ky formular shërben për deklarin e tre llojeve të detyrimeve tatimore :

- Të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore,
- Të Kontributeve të Sigurimeve Shëndetësore,
- Të Ardhurave nga Punësimi për punëmarrësit.

Variablat e skedarit janë tre lloje: variablat e skedarit origjinal nga DPT, variabla shtesë nga INSTAT dhe variabla të derivuar. Dy variablat kryesorë të interesit në këtë skedar janë Numri i punonjësve dhe Paga bruto paguar punëmarrësit.

Përkufizime

Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr mesatarisht një i punësuar për punën që ka kryer në një muaj.

Ajo përbëhet nga:

- Paga bazë për punën e kryer
- Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese
- Shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë
- Shtesa mbi pagë për vështirësi në punë
- Shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.)
- Shpërblime
-

Në pagën mesatare mujore bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.

Paga minimale mujore - është paga më e ulët e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Klasifikime

- Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev. 2, si më poshtë:

NVE Rev.2 (Seksioni)	Përshkrimi
A	Bujqësia, pyjet, peshkimi
B	Industria nxjerrëse
C	Përpunimi
D	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F	Ndërtimi
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave
H	Transporti dhe magazinimi
I	Akomidimi dhe shërbimi ushqimor
J	Informacioni dhe komunikacioni
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit
L	Aktivitete të pasurive të paluajtëshme
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse
O	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm
P	Arsimi
Q	Shëndetsia dhe aktivitete tëpunës sociale
R	Arte, argëtim dhe çlodhje
S	Aktivitete të tjera shërbimi
T	Aktivitetet të familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet
U	Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare

- Klasifikimi i profesioneve është bërë sipas Klasifikimit Nderkombëtar të Profesioneve, ISCO-08, si më poshtë:

ISCO_08	Përshkrimi
1. Manaxher	
11	Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtorë ekzekutivë
12	Drejtuues administrativë dhe komercialë
13	Drejtuues prodhimi dhe shërbimesh të specializuara
14	Drejtuues të shërbimeve të mikpritjes, të tregtisë me pakicë dhe shumicë dhe shërbimeve të tjera shërbimeve të tjera
2. Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)	
21	Specialistë të shkencave dhe inxhinierisë
22	Specialistë të shëndetësisë
23	Specialistë të mësimdhënies
24	Specialistë të administrimit dhe biznesit
25	Specialistë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit
26	Specialistë në fushën ligjore, shoqërore dhe kulturore
3. Teknikë dhe specialistë në zbatim	
31	Bashkëpunëtorë profesionistë në inxhinieri dhe shkencë
32	Asistentë të specializuar të shëndetësisë
33	Asistentë në administrim dhe biznes
34	Specialistë ligjor, shoqëror, kulturor dhe të tjera të ngjashme
ISCO_08	Përshkrimi

35	Teknikë të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)
4.	Nëpunësit
41	Nëpunës dhe mbështetës zyre
42	Nëpunës të shërbimit të klientëve
43	Nëpunës për llogaritje dhe regjistrimit të materialeve
44	Nëpunës të tjerë mbështetës në zyrë
5.	Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve
51	Punonjës të shërbimeve personale
52	Punonjës shitje
53	Punonjës të kujdesit personal
54	Punonjës të shërbimeve të mbrojtjes
6.	Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit
61	Punonjës të kualifikuar të bujqësisë për treg
62	Punonjës të kualifikuar pyjeve, peshkimit, gjahtarë dhe vendosës kurthesh, për treg
63	Prodhues të produkteve bujqësore, blegtorale, të peshkimit për nevoja familjare
7.	Zejtare, artizanë dhe profesione të lidhura me to
71	Punonjës të ndërtimit dhe profesione të lidhura me to (përjashtuar elektrikist)
72	Punëtorë të punimit të metaleve dhe montimit të makinerive
73	Punonjës të prodhimit të sendeve të imta, punëve me dorë (artizanët), të
74	Punonjës në profesionet e elektro-teknologjisë
75	Punonjës të përpunimit të ushqimit, drurit, tekstileve dhe tjera të ngjashme
8.	Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve
81	Punonjës të uzinave dhe përdorues të makinerive dhe pajisjeve
82	Montues
83	Drejtues automjeti dhe punëtorë të makinave industriale
9.	Punëtorë (Profesione elementare)
91	Punëtorë shërbimi dhe ndihmës
92	Punëtorë të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit
93	Punëtorë në miniera, ndërtim, industri e transport
94	Ndihmës në përgatitjen e ushqimit
95	Punëtorë për shitje dhe shërbime të ndryshme në rrugë
96	Mbledhës plehrash dhe punëtorë të shërbimeve të tjera elementare
0.	Forcat e Armatosura
01	Oficer i Forcave të Armatosura
02	Nënoficer i Forcave të Armatosura
03	Pozicione të Forcave të Armatosura, rangje të tjera